

Ndërtimi i Paqes Mjedisore

Hulumtimi i udhëhequr nga të rinjtë në Kosovë mbi
Mjedisin dhe Mirëqenien

Hyrje


Eksplorimi i te rinjve dhe mjedisit

Kosova vazhdon të përballlet me dinamika komplekse pas konfliktit, njëkohësisht me rritjen e presioneve mjedisore dhe klimatike. Ndotja e ajrit, mungesa e burimeve ujore, menaxhimi jo i qëndrueshëm i mbeturinave, degradimi i tokës dhe trajtimi i kufizuar i ujërave të zeza prekin komunitetet në mbarë vendin dhe janë shëndrruar në shqetësime të përditshme për shumë qytetarë. Ndonëse këto sfida shpesh trajtohen si çështje teknike apo thjesht mjedisore, ato bartin edhe implikime të qarta sociale dhe për ndërtimin e paqes. Degradimi i mjedisit ndikon drejtëpërdrejtë në shëndet, në burimet e jetesës, në besimin ndaj institucioneve dhe në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve.

Ky hulumtim e pozicionon mjedisin si një pikë hyrëse neutrale dhe gjithëpërfshirëse për ndërtimin e paqes dhe angazhimin e të rinjve. Rreziqet mjedisore kapërcejnë ndarjet etnike, politike dhe gjeografike, duke prekur në mënyrë të barabartë komunitetet shqiptare, serbe dhe komunitetet tjera. Në një kontekst ku marrëdhëniet ndëretnike mbeten të ndjeshme, shqetësimet e përbashkta mjedisore ofrojnë mundësi të rralla për dialog, bashkëpunim dhe zgjidhje të përbashkta të problemeve. Studimi fokusohet tek të rinjtë si aktorë kyç, duke njohur njëkohësisht cënueshmërinë e tyre ndaj stresorëve mjedisorë dhe atyre të shëndetit mendor, si dhe potencialin e tyre për të vepruar si ndërtues urash ndërmjet komuniteteve të ndara.

Hulumtimi është realizuar në kuadër të një iniciative për ndërtimin e paqes të udhëhequr nga të rinjtë, e zbatuar nga organizata për ndërtimin e paqes Pro Peace, në partneritet me organizatën lokale SIT. Qëllimi i tij është të kuptohet se si sfidat mjedisore kontribuojnë në tensionet sociale dhe se si angazhimi i të rinjve rreth çështjeve mjedisore dhe të mirëqenies mendore mund të mbështesë kohezionin social dhe dialogun ndëretnik. Të dhënat janë mbledhur përmes anketave, intervistave dhe katër (4) diskutimeve në fokus grupe. Janë përfshirë dy anketa online me gjithsej 150 të rinj, anketa ballë për ballë përmes tabletëve me pjesëmarrës dhe akterë relevantë, intervista të thelluara me anëtarë të komunitetit, institucione dhe aktorë ndërkombëtarë, pyetësorë të strukturuar me 12 përfaqësues institucionalë, si dhe katër fokus grupe me pjesëmarrjen e 28 të rinjve dhe anëtarëve të komunitetit.

Sipas perceptimit të të rinjve, problemet mjedisore në komunitetet e tyre vlerësohen si shumë serioze nga 45%, serioze nga 34.4%, ndërsa 11.3% i konsiderojnë ato jo serioze.



Konteksti dhe Sfondi

Konteksti mjedisor dhe klimatik

Kosova përballlet me një sërë sfidash mjedisore, përfshirë cilësinë e dobët të ajrit, rritjen e ekstremeve të nxehtësisë, mungesën e burimeve ujore, ndotjen e lumenjve, deponitë e paqëndrueshme dhe trajtimin e kufizuar të ujërave të zeza. Këto presione përkeqësohen më tej nga ndryshimet klimatike dhe kapacitetet e dobëta të shërbimeve komunale në shumë zona. Komunitetet rurale dhe zonat e banuara nga komunitetet pakicë janë shpesh më të ekspozuara ndaj këtyre sfidave për shkak të infrastrukturës së kufizuar dhe mungesës së investimeve.

Sipas renditjes së të rinjve, tri sfidat kryesore mjedisore janë: menaxhimi i mbeturinave (32.4%), ndotja e ajrit (20.6%) dhe ndotja e ujit (20.6%).

Trashëgimia e konfliktit të viteve 1990 e ndërlikon më tej menaxhimin mjedisor. Minat tokësore dhe mjetet shpërthyese të pashpërthyera vazhdojnë të kufizojnë përdorimin e sigurt të tokës në disa zona, duke penguar bujqësinë, kullotjen dhe zhvillimin e komunitetit. Në këto kontekste, degradimi mjedisor forcon ndjesinë e cenueshmërisë dhe të braktisjes nga institucionet.

Konteksti dhe Sfondi

Marrëdhënia historike ndërmjet komuniteteve dhe mjedisit

Gjatë periudhës së Jugosllavisë dhe përgjatë viteve '90, shumë komunitete në Kosovë vareshin në masë të madhe nga toka dhe burimet natyrore, si pasojë e përjashtimit ekonomik dhe qasjes së kufizuar në shërbime publike. Pas luftës, migrimi i brendshëm në shkallë të gjerë nga zonat rurale drejt qendrave urbane uli kujdesin lokal ndaj tokës dhe dobësoi praktikën tradicionale të menaxhimit mjedisor. Ky ndryshim kontribuoi në degradimin e mjedisit, veçanërisht në zonat rurale dhe periferike, ku mbetën më pak banorë për të kërkuar shërbime apo mbrojtje mjedisore.

ghj

Mjedisi, Mirëqenia Mendore dhe Tensionet Sociale

Stresorët mjedisorë ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien mendore. Të intervistuarit lidhën shpesh ndotjen, ujin e pasigurt dhe menaxhimin e dobët të mbeturinave me ankth, ndjenjë pasigurie dhe frustrim. Kur dëmet mjedisore perceptohen si të pabarabarta ose të neglizhuara, ato mund të thellojnë mosbesimin ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve, dhe në disa raste edhe ndërmjet grupeve etnike. Këto dinamika e pozicionojnë mjedisin njëkohësisht si burim tensioni dhe si një pikë hyrëse potenciale për ndërtimin e paqes.

Në lidhje me konfliktet mjedisore, 16.6% e të rinjve deklaruan se kanë qenë dëshmitarë të mosmarrëveshjeve apo konflikteve mjedisore, ndërsa 83.4% raportuan se nuk kanë përjetuar situata të tilla.

Sa i përket qëndrimeve ndaj sfidave mjedisore, 38.5% e të rinjve shprehën ndjenjë frustrimi, 30.8% identifikuan tensione, 23.1% theksuan rolin e të rinjve, ndërsa 7.7% përmendën veprimin komunitar si përgjigje ndaj këtyre sfidave.

Qëllimet dhe Pyetjet e Hulumtimit

Ky hulumtim ka pasur për qëllim:

- Të kuptojë se si sfidat mjedisore ndikojnë në jetën e përditshme, mirëqenien dhe perceptimet për drejtësi ndërmjet komuniteteve.
- Të eksplorojë mënyrën se si çështjet mjedisore kontribuojnë në tensionet e brendshme dhe ndëretnike.
- Të shqyrtojë perceptimet, rolet dhe kapacitetet e të rinjve në adresimin e sfidave mjedisore dhe sociale.
- Të identifikojë mundësi për shfrytëzimin e angazhimit mjedisor si mjet për ndërtimin e paqes.

Pyetjet kryesore të hulumtimit kanë përfshirë:

1. Si i përjetojnë komunitetet e ndryshme sfidat mjedisore në Kosovë?
2. Si lidhen çështjet mjedisore me tensionet sociale, besimin dhe marrëdhëniet ndëretnike?
3. Si e perceptojnë të rinjtë rolin e tyre në adresimin e sfidave mjedisore dhe të mirëqenies mendore?
4. Si mund të kontribuojë veprimi mjedisor i udhëhequr nga të rinjtë në ndërtimin e paqes dhe kohezionin social?

- Pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete të lidhura me mjedisin dhe/ose ndërtimin e paqes (76.85 po, 23.3% jo).
- Motivimet kryesore për angazhim mjedisor kanë qenë: shëndeti (72.8%), mbrojtja e mjedisit (70.9%), mirëqenia e komunitetit (37.1%), drejtësia sociale (12.6%) dhe mundësitë ekonomike (11.3%).
- Pengesa në angazhimin e të rinjve: mungesa e njohurive 53.6%, mungesa e mundësive 41.1%, mbështetja e kufizuar nga autoritetet 39.1%, mungesa e fondeve 31.8%.

Metodologjia

Ky studim ka përdorur një qasje hulumtuese cilësore dhe pjesëmarrëse, të udhëhequr nga të rinjtë, duke kombinuar metoda cilësore dhe sasiore me qëllim të kapjes së perspektivave të ndryshme.

Metodat e Mbledhjes së të Dhënave

- Intervista me Informatorë Kyç: Janë realizuar me përfaqësues komunalë, ambasada, organizata ndërkombëtare joqeveritare, ekspertë të mjedisit, aktorë të shoqërisë civile dhe liderë të komunitetit.
- Diskutime në Fokus Grupe: Janë mbajtur me të rinj nga përkatësi të ndryshme etnike në disa lokacione, përfshirë zona të përziera dhe zona me diversitet etnik.
- Intervista Gjysmë të Strukturuara: Janë realizuar me anëtarë të komunitetit të prekur nga sfidat mjedisore, me qëllim të kuptimit më të thellë të përvojave dhe perceptimeve të tyre.
- Pyetësi për të Rinjtë (online): Është shpërndarë për të mbledhur perceptime, nivelin e ndërgjegjësimit dhe përvojat e të rinjve lidhur me çështjet mjedisore, mirëqenien mendore dhe marrëdhëniet sociale.

Pyetësi online ka synuar grupe të të rinjve, nxënës dhe vullnetarë të komunitetit të moshës 14–29 vjeç. Nga respondentët, 67.3% ishin meshkuj dhe 32.7% femra, ndërsa 83.4% ishin në nivel të arsimit të mesëm dhe 15.2% në nivel universitar. Pjesëmarrësit përfaqësuan një gamë të gjerë komunash, me pjesëmarrjen më të lartë nga Prishtina dhe Mitrovica, duke reflektuar si kontekste urbane ashtu edhe ato pas konfliktit.

Projektet e preferuara të udhëhequra nga të rinjtë: menaxhimi i mbeturinave 62.9%, mbjellja e drunjve/gjelbërimi 53.6%, fushatat e ndërgjegjësimit 27.2 %, dialogu ndërkomunitar 26.5%, krijimi i më shumë parqeve dhe hapësirave të gjelbra 2%, si dhe vaksinimi/kontrolli i kafshëve 0.7%.

Marrja e mostrave dhe vendndodhjet

Aktivitetet hulumtuese janë zhvilluar në disa komuna, përfshirë Prishtinën, Mitrovicën, Gjilanin dhe Gjakovën. Pjesëmarrësit kanë përfshirë anëtarë të komuniteteve shqiptare, serbe dhe komuniteteve të tjera, me fokus të veçantë tek të rinjtë.

Kufizimet

Ky hulumtim ka vënë theksin më shumë në thellësinë e analizës sesa në përfaqësimin statistikor. Gjetjet pasqyrojnë perceptimet dhe përvojat e jetuara të pjesëmarrësve, dhe jo të dhëna të përgjithësueshme statistikisht. Megjithatë, qëndrueshmëria e rezultateve ndërmjet metodave të ndryshme hulumtuese e forcon vlefshmërinë e gjetjeve.

Gjetjet

Sfidat Mjedisore si Shqetësime të Përbashkëta

Në intervista, diskutime në fokus grupe dhe pyetësorë, pjesëmarrësit identifikuan në mënyrë të qëndrueshme ndotjen, menaxhimin e mbeturinave, cilësinë e ajrit dhe ndotjen e ujit si shqetësime kryesore mjedisore.

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se degradimi mjedisor gjeneron frustrim dhe marrëdhënie të tendosura me autoritetet, por gjithashtu nxjerrin në pah potencialin e pashfrytëzuar për lidhshërinë e rinjve në adresimin e sfidave mjedisore në mes të angazhimit të kufizuar të komunitetit. Këto gjetje ilustrojnë se ndotja dhe menaxhimi i dobët i mbeturinave janë burimet kryesore të frustrimit (38.5%), të ndjekura nga perceptimet se problemet mjedisore shkaktojnë tension me autoritetet (30.8%). Ndërsa 23.1% besojnë se të rinjtë mund të luajnë një rol kyç, vetëm 7.7% mendojnë se komuniteti i tyre mbron në mënyrë aktive mjedisin.

Ndikimi i Pabarabartë dhe Perceptimi i Neglizhencës

Megjithëse sfidat mjedisore prekin gjerësisht komunitetet, ndikimi i tyre nuk është i shpërndarë në mënyrë të barabartë. Pjesëmarrësit nga komunitetet rurale dhe ato të pakicave raportuan shërbime komunale më të dobëta, reagim të kufizuar institucional dhe ekspozim më të lartë ndaj rreziqeve mjedisore.

Renditja e tre sfidave më urgjente mjedisore: menaxhimi i mbeturinave 32.4%, ndotja e ajrit 20.6%, ndotja e ujit 20.6%, ndotja industriale 11.8%, përmbytjet/thatësit 8.8%.

Stresi Mjedisor dhe Mirëqenia Mendore

Degradimi mjedisor është lidhur ngushtë me stresin, ankthin dhe ndjenjat e pasigurisë.

Pjesëmarrësit vazhdimisht e lidhën neglizhencën mjedisore me ndikimet negative në shëndetin mendor, duke përfshirë stresin psikologjik, frustrimin dhe uljen e kënaqësisë nga hapësirat publike dhe arsimore. Këto efekte u panë si kontribuese në tensionin social dhe marrëdhëniet e tendosura ndërpersonale brenda shkollave dhe komuniteteve. Në këtë kontekst, pjesëmarrësit theksuan se riciklimi, i praktikuar gjerësisht në vendet e zhvilluara, duhet të miratohet herët dhe vazhdimisht si një hap praktik drejt përmirësimit të kushteve mjedisore dhe mirëqenies. Mjediset shkollore të mirëmbajtura dobët dhe të zymta, veçanërisht në shkollat teknike, u theksuan si dëmtuese të mëtejshme të moralit, rritjes së nervozizmit dhe uljes së mirëqenies së përgjithshme

Mjedisi dhe Marrëdhëniet Ndëretnike

Çështjet mjedisore janë përshkruar shpesh si një nga fushat e pakta ku bashkëpunimi ndëretnik perceptohet si i mundshëm.

Pjesëmarrësit dhe të rinjtë theksuan se çështjet mjedisore njihen gjerësisht si shqetësime të përbashkëta që prekin ndarjet etnike dhe sociale. Meqenëse ndotja, mbeturinat dhe cilësia e ujit në fund të fundit ndikojnë në të gjitha komunitetet, mbrojtja e mjedisit u pa si një pikë hyrëse relativisht neutrale dhe jo e politizuar për dialog, veprim kolektiv dhe ndërtim paqeje, me kusht që pabarazitë ekzistuese në ekspozim dhe akses të pranohen dhe të adresohen hapur

Agjencia Rinore, Pjesëmarrja dhe Përfundimi

Të rinjtë pjesëmarrës shprehën motivim të lartë për adresimin e çështjeve mjedisore dhe e njohën potencialin e tyre si agjentë të ndryshimit.

•Pajtueshmëri me deklaratat mbi rreziqet klimatike, degradimin mjedisor dhe veprimin institucional.

Diskutim: Mjedisi si Mjet për Ndërtimin e Paqes

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se sfidat mjedisore veprojnë njëkohësisht si burime stresi dhe si mundësi për veprim të përbashkët. Kur nuk menaxhohen në mënyrë të duhur, ato nxisin frustrim, mosbesim dhe tensione sociale. Në të kundërt, kur trajtohen përmes qasjeve bashkëpunuese, ato ofrojnë një platformë neutrale dhe gjithëpërfshirëse për angazhim qytetar. Hulumtimi dhe veprimet mjedisore të udhëhequra nga të rinjtë u mundësojnë të rinjve nga prejardhje të ndryshme të bashkëpunojnë rreth shqetësimeve të përbashkta, duke zhvendosur fokusin nga ndarjet e bazuara në identitet drejt përgjegjësisë kolektive.

Integrimi i mirëqenies mendore në angazhimin mjedisore forcon ndjeshmërinë, njohën dhe ndërtimin e besimit ndërmjet individëve dhe komuniteteve. Po ashtu, angazhimi me komunat dhe institucionet kontribuon në rritjen e llogaridhënies dhe në forcimin e besimit vertikal ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve publike

- Komunitetet ose sektorët më të prekur nga çështjet mjedisore: zonat rurale, urbane, minoritetet, të rinjtë, zonat industriale.
- Strategjia/buxheti institucional për përshtatjen mjedisore: 6 po, 5 jo.
- Vlerësimet e koordinimit me institucione të tjera, shoqërinë civile, donatorët, komunitetet lokale.
- Pengesa kryesore për menaxhim efektiv mjedisor: financim 81.8%, prioritet i ulët politik 81.8%, mungesë kapaciteti teknik 45.5%, koordinim i dobët 45.5%, ndërgjegjësim i ulët publik 36.4%.
- Shpeshtësia e mosmarrëveshjeve mjedisore: herë pas here 45.5%, shpesh 27.3%, rrallë 18.2%, shumë rrallë 9.1%.
- Çështjet që gjenerojnë më shumë tension: mbeturinat/deponitë 72.7%, shërbime të pabarabarta 54.5%, akses në ujë 45.5%, përdorim i tokës 45.5%, ndotje nga fabrikat 27.3%.
- Përfshirja e institucioneve në mosmarrëveshjet mjedisore: 6 po, 5 jo.
- Vlerësimi i ndërgjegjësimit publik: përgjithësisht i kufizuar.
- Mbështetje e nevojshme për të forcuar reagimin institucional mjedisor: financim 81.8%, trajnim 54.5%, koordinim 45.5%, ekspertizë teknike 45.5%, angazhim publik 27.3%.

Citate

- “Ne shohim ndotje çdo ditë, por nuk shohim veprime të vërteta nga institucionet.”
- “Cilësia e ajrit ndikon në shëndetin dhe jetën tonë të përditshme, veçanërisht gjatë dimrit.”
- “Ka shumë ligje mjedisore, por ato nuk zbatohen në terren.”
- “Të rinjtë dua të kontribuojnë, por nuk ka mundësi ose mbështetje konkrete.”
- “Problemet mjedisore diskutohen shpesh, por përgjegjësia gjithmonë zhvendoset.
- “Sa herë që bie borë, bora e bardhë shpejt kthehet në kafe, duke treguar nivelin e ndotjes së ajrit.”
- “Ekziston vetëm një planet. Mbrojtja e tij është përgjegjësi e përbashkët e të gjithëve.”

Konkluzione

Sfidat mjedisore në Kosovë janë thellësisht të ndërlidhura me kohezionin social dhe ndërtimin e paqes. Ndotja, mungesa e burimeve ujore dhe neglizhenca mjedisore ndikojnë në mirëqenien mendore dhe në besimin ndaj institucioneve, veçanërisht tek të rinjtë dhe komunitetet pakicë. Njëkohësisht, këto sfida të përbashkëta krijojnë mundësi për dialog dhe bashkëpunim ndëretnik, kur adresohen përmes një qasjeje të ndërtimit të paqes mjedisore.

Angazhimi i udhëhequr nga të rinjtë, që ndërlidh mjedisin me shëndetin mendor, mund të forcojë kohezionin social, të nxisë marrdhënie ndërkomunitare dhe të mbështesë procese vendimarrëse më gjithëpërfshirëse dhe më të ndjeshme ndaj nevojave të komuniteteve.

Rekomandime

- Mbështetni iniciativat mjedisore të udhëhequra nga të rinjtë si masa për ndërtimin e besimit dhe paqes.
- Integroni mirëqenien mendore në programet dhe politikat mjedisore.
- Krijoni platforma gjithëpërfshirëse për dialogun ndëretnik rinor rreth çështjeve mjedisore.
- Forconi bashkëpunimin midis të rinjve, komunave dhe shoqërisë civile.
- Jepni përparësi komuniteteve të cënueshme dhe të marginalizuara nga ana mjedisore në politika dhe praktikë.

HULUMTIM

Ky raport u bë i mundur nga Pro Peace në Kosovë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Social dhe Hulumtime. Ai nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Pro Peace në Kosovë.



Ky hulumtim u krye nga një grup prej më shumë se 30 hulumtues të rinj që përfaqësonin katër qytete në të gjithë Kosovën. Procesi i hulumtimit u drejtua nga Kadri Gashi, Drejtor Ekzekutiv i SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Humtime, dhe Wesam Al Mubarak, Menaxher i Projektit në Pro Peace Kosovë. Hulumtuesit e rinj ishin të angazhuar në mënyrë aktive në të gjitha fazat e studimit, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, analizën dhe reflektimin, duke kontribuar me perspektiva të ndryshme lokale dhe duke siguruar që hulumtimi të bazohet në përvojat në nivel komuniteti.

Na Kontaktoni

www.sit-ks.org

www.propoace.de/en